



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2019:108354

Datë: 06.01.2020

Numri i dokumentit: 00748624

**P.nr.103/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMLORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me sekretaren juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale, kundër të akuzuarit R. I. nga fsh. B. K. Mitrovicë, të cilin e akuzon P.TH. Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1021-5/2009, të dt.24.12.2012, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328 par.1 të KPK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.06.01.2020, në prani të përfaqësuesit të prokurorisë Rrahim Podvorica, dhe të akuzuarit, me po të njëjtën datë, merr dhe shpallë publikisht këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Ndaj të akuzuarit:

**R. I.**, i lindur me dt *data e lindjes...*, në fshatin B., komuna e Mitrovicës, ku edhe jeton, nga i ati A.dhe ëmes H., e gjinisë T., i martuar, babë i 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor i sigurimit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, mbrohet në liri.

### **ËSHTË FAJTORË**

#### **Sepse:**

Me datën 05.08.2009, rreth orës 20:20 min, e ka përdorur armën me kërcnim, në atë mënyrë që pasi ka shkuar në lokalit “B.”, në fshatin G. e E., komuna e Lipjanit, ka gjuajtur dy here me pushkë automatike AK-47, te shanku i lokalit, duke iu drejtuar me fjalë kërcënuese punëtorëve të lokalit, tani të dëmtuarve Xh. T., N. T. dhe F. .T. ashtu që të njëjtit nga frika kanë ikur me shpejtësi nga lokali,ndërsa të pandehurit duke ikur me veturën e tipit “BMW”, me targa targa..., i bie telefoni i tipit “Nokia”, e pas kësaj të dëmtuarit rastin e paraqesin në polici,

-me këtë e kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328 par.1 KPK-së.

-Andaj gjykata konformë neneve 1, 2, 3, 5, 12, 14, 15, 34, 35, 36, 39, 64 dhe nenit 328 par.1 të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

### **DËNIM ME GJOBË**

Në shumë prej 300.-€ (treqindeuro), të cilin i akuzuari është i obliguar t’a paguajë, në afat prej 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do t'a zëvendësojë me dënim me burgim, konform nenit 39 par.4 të KPRK-së, ashtu që për qdo ditë të qëndruar në burg, të llogaritet shuma prej 20.-€.

**Të dëmtuarit**, Xh. T., N. T. dhe F.T. udhëzohen që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt gjyqësore.

**DETYROHET**, i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve te procedurës penale, për paushall gjyqësor shumë prej 20.-€, si dhe shumë prej 30.-€, në Fondin për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e sajë PP. II.nr.1021-5/2009 të dt.24.12.2012, e ka akuzuar të akuzuarin R.I. nga fsh. B.K. Mitrovicë, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328 par.1 KPK-së.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, si dhe pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare e kjo konform dispozitave ligjore, pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, më tutje i ka propozuar që të njëjtin t'a shpallë fajtorë dhe t'a dënojë sipas ligjit.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor pasi që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën ka deklaruar se e ndien veten fajtor, për veprën penale që i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se ndihet i penduar për atë që ka bërë, dhe se është mbajtës i familjes 6 antarshe, i gjendjes së dobët ekonomike, e ka lutur gjykatën që t'i shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, si dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Rafet Ibishi nga fsh. Bajgorë K. Mitrovicë, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese conform nenit 64 të KPK-së, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen para kryerjes së veprës penale për të akuzuarin, pra faktin se i njëjti për here të pare ka rënë ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është mbajtës i familjes 6 antarshe, dhe i gjendjes së dobët ekonomike, sjelljen pas kryerjes së veprës penale, pra premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të t'akuzuarit, pra faktin se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës ka qenë plotësisht i aftë të kuptoi sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese, dhe duke marrur parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë i bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 34 të KPK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazojë konformë dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërsa vendimi për pagesën e shumës në Fondin e Viktimave u bazua në nenin 39 të Ligjit për mbrojtjen e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.**

**P.nr.103/19 me dt.06.01.2020**  
**Sekretarja juridike,**  
**Nexhmije Ahmeti**

**GJYQTARI,**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij akgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.